



Nr. 30 Prot.

Dt.04.02.2019

Objekti: Shtyrja e procesit të regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit.

VENDIM NR.16

Bazuar në VKM nr. 782, dt. 26.12.2018, pika 6, për “Përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, shkresën e MASR me Nr. 322, Prot., datë 14.01.2019, pika 5, Vendimin e Senatit Akademik nr. 06 më datë 23. 01. 2019 për “Shpalljen e zgjedhjeve te reja, për 1 vend nga radhët e përfaqësuesve të MASR, si ekspertë të njohur në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike, për anëtar të bordit të administrimit, i cili do të përzgjidhet nga studentët e Universitetit te Arteve”, Vendimin Nr. 10, datë 26.01.2019 të KIZ UART dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”:

KIZ UART pas përfundimit të afatit të regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit dhe regjistrimit në proces të një kandidati të vetëm; pasi shqyrtoi bazën ligjore të mësipërme, specifikisht pikën 6 të VKM nr. 782, dt. 26.12.2018 dhe pikën 5 të shkresës së MASR me Nr. 322, Prot., datë 14.01.2019, vlerësoi se në mungesë të kandidaturave të mjaftueshme, nuk mund të shpallë listën e kandidatëve të regjistruarve për anëtar të Bordit të Administrimit në UART dhe për sa më sipër, vendosi:

Të shtyjë procesin e regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit në UART. Periudha e dytë e regjistrimit të kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit, fillon më datë 11.02.2019, ora 08.00 deri më datë 13.02.2019, ora 16:00. Të gjithë të interesuar për të vetëkandiduar për pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit ftohen të depozitojnë formularin e aplikimit së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë KIZ.

Kryetar

Laert Qazimi



Sekretar

Viktor Ferraj

Anëtar Andrea Canaj

Anëtar Laert Qazimi

Anëtar Harri Aleksi

Anëtar Genc Përmeti